

Politika e Privatësisë së Rekrutimit

Kjo Politikë ju informon sesi Balfin Shpk mbledh dhe përdor të dhënat tuaja personale në lidhje me rekrutimin pranë kësaj shoqërie, online, përmes postës apo dorazi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë. Dhënia e informacionit tuaj personal lidhur me rekrutimin ose procesin e aplikimit për punësim konfirmon pëlqimin tuaj për mbledhjen e këtij informacioni nga Balfin Shpk dhe përdorimin, shpërndarjen, mbajtjen apo ndarjen e tij me palë të treta, siç specifikohet në këtë politikë dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Balfin Shpk (më poshtë referuar shkurtimisht si "**Balfin**") shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me datë 11.09.2007, me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga Rruga 'Papa Gjon Pali II', ABA Business Center, Kati i 11-të, Tiranë, Shqipëri.

Mbledhja e të dhënave personale. Kur kërkohen të dhëna lidhur me edukimin dhe punësimin, kontaktimin, kualifikimin apo preferencat tuaja dhe punën/-ët për të cilat ju aplikoni, mund t'ju kërkohet jepni të dhëna personale Balfin.

Gjithashtu, ju mund t'i mundësoni Balfin-it informacion shtesë, si CV/jetëshkrimi juaj, referenca punësimi apo informacion që lidhet me të, si dhe kërkesën tuaj për një pagë të caktuar. Gjithashtu, Balfin mund të mbledhë informacion nga palët e treta, për shembull në lidhje me punësimin dhe/ose referenca për këtë.

Balfin nuk përpunon të dhëna sensitive të përcaktuara në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr. 9887, i datës 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Përhapje e vullnetshme. Dhënia e informacionit personal në lidhje me rekrutimin do të jetë në përputhje me vullnetin tuaj të lirë dhe vetëm ju përcaktoni masën e të dhënave që ju i jepni Balfin-it. Lutemi të merrni në konsideratë se nëse vendosni mos të jepni këtë informacion ose një pjesë të informacioneve dhe të të dhënave personale të kërkuara, kjo mund të afektojë mundësinë e Balfin për të kryer një vlerësimi të plotë dhe për rrjedhim vendimmarrjen tonë lidhur me punësimin tuaj.

Përdorimi i të dhënave personale. Informacioni mund të përdoret për të komunikuar me ju, administrimin e proceseve të rekrutimit dhe punësimin në Balfin dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe politikat e brendshme të Balfin. Nëse punësoheni, informacioni mund të përdoret lidhur me punësimin dhe menaxhimin e korporatës.

Balfin mund të përpunojë të dhënat tuaja personale, së brendshmi ose me ofruesit e shërbimeve dhe palë të tjera të treta siç mund të jetë e nevojshme në lidhje me rekrutimin, punësimin, politikat e brendshme të Balfin, kuadrin ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë. Balfin u kërkon palëve të treta të mbajnë konfidenciale këto të dhëna dhe t'i përdorin ato vetëm për qëllimin specifik për të cilin është dhënë ky informacion.



Balfin do të ruajë këto të dhëna për 24 muaj nga data e paraqitjes së tyre ose përditësimit të fundit të kryer prej jush. 12 muaj mbas paraqitjes ose përditësimit, të dhënat do të anonimizohen dhe nuk do të jenë të aksesueshme për rishikim.

Brenda periudhës së ruajtjes së të dhënave tuaja personale Balfin mund të kalojë këto të dhëna tek shoqëri të tjera të Grupit Balfin, të cilat mund të kenë interes të punësojnë person me profilin tuaj profesional dhe ju në këtë mënyrë jepni miratimin tuaj për përpunimin e të dhënave nga shoqërisë marrëse dhe pranoi që mund të kontaktoheni prej ndonjë prej tyre për qëllim rekrutimi për pune.

Nëse jeni të suksesshëm gjatë procesit të rekrutimit dhe bëheni punëmarrës i Balfin, të dhënat tuaja personale do të jenë pjesë e dosjes suaj të punëmarrësit, mund të përdorën për qëllime të lidhura me punësimin ose punën.

Siguria dhe Konfidencialiteti. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë politikë ose siç mund të kërkohe për qëllime ligjore ose rregullatore, Balfin trajton të dhënat tuaja personale si konfidenciale dhe nuk do t'i përhapë ato te palët e treta pa pëlqimin tuaj. Balfin mban dhe bashkëpunon vetëm me ofrues të shërbimesh që marrin masa apo kryejnë kontrole të arsyeshme administrative, teknike dhe fizike për të ruajtur konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave tuaja personale.

Punëmarrësit e Balfin të cilët mund të kenë akses në të dhëna personale kanë marrë përsipër të ruajnë këtë informacion konfidencial.

Balfin përdorë politika sigurie në ambientet dhe sistemet e veta kompjuterike për të mbikëqyrur dhe ruajtur sigurinë. Çdo mbikëqyrje kryhet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Ruajtja dhe akses. Balfin mund të ruajë të dhënat tuaja për t'ju marrë në konsideratë për mundësi të tjera punësimi. Në masën që lejohet nga ligji, Balfin mund të fshijë të dhëna në çdo kohë dhe ju duhet të ruani një kopje të informacionit tuaj të depozituara pranë nesh.

Ju mund të keni akses dhe të korrigjoni të dhënat tuaja personale duke na shkruar në adresën elektronike ose postare të përcaktuar më poshtë në këtë politikë.

Përgjegjësitë tuaja. Ju jeni përgjegjës për informacionin që i jepni apo i mundësoni Balfin dhe duhet të siguroheni që ky informacion është i vërtetë. Ju duhet të siguroheni që ky informacion nuk përmban materiale që shkelin të drejta të palëve të treta dhe që është në përputhje të plotë me ligjin dhe nuk mund të jetë objekt i pretendimeve ligjore. Për më tepër, nëse jepni informacione që kanë të bëjnë me persona të tjerë, si p.sh individë që mund të jenë referenca juaj, ju jeni përgjegjës për t'i njoftuar ata/ato paraprakisht dhe të merrni të gjitha pëlqimet e nevojshme në mënyrë që Balfin të mbledhë dhe të përdorë të dhënat e përkruara në këtë politikë.



E përgjithshme. Balfin mund t'a përditësojë këtë politikë kohë pas kohe dhe versioni në fuqi do të jetë gjithmonë online. Nëse ju keni pyetje, ankesa apo kërkesa lidhur me këtë politikë ose zbatimin e saj, si dhe dëshironi të korrighoni të dhënat tuaja, lutemi na shkruani online në adresën: hr@balfin.al ose me postë në adresën:

Balfin Shpk
Rr. "Papa Gjon Pali II", kati 11, ABA Center, P.O. Box. 1010, Tiranë.

Balfin, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës apo kërkesës, do t'ju informojë mbi kërkesën tuaj dhe informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa. Në rast se nuk ju jepet informacioni, Balfin duhet t'ju shpjegojë arsyet e mosdhënies së informacionit.

Kjo Politikë e Privatësisë së Rekrutimit hyn në fuqi në datën e publikimit të saj në faqen zyrtare të Balfin.

Balfin Shpk

